



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 01 /2019 PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE/NXËNËSVE NË INTERNET, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION NO. 01 /2019 ON CHILDREN/STUDENT ONLINE PROTECTION AT THE
PRE-UNIVERSITY EDUCATION INSTITUTIONS

ADMINISTRATIVNA UREDBA BR. 01 /2019 O ZAŠTITI DECE/UČENIKA NA INTERNET, U INSTITUCIJAMA
PREDUNIVERZITETSKOG OBRAZOVANJA

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1, nenit 5 paragrafit 16 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në bazë të Rregullores së Qeverisë nr. 21/ 2013 për Protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar, nenit 8 paragrafi 1, pika 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta zyrtare nr. 1, 18 prill 2011), nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV
NR. ____/2018 PËR MBROJTJEN E
FËMIJËVE/NXËNËSVE NË
INTERNET, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

**Neni 1
Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese në nivelin parauniversitar, të adresojnë mbrojtjen e fëmijëve/ nxënësve në internet nëpërmjet procesit të rregull

Minister of Education, Science and Technology.

pursuant to article 4 paragraph 1, article 5 paragraph 16 of the Law no. 04/L-032 on Pre-university education in the Republic of Kosovo, based on the government's regulation no. 21/2013 for the Protocol for prevention and referral of violence at the Pre-university Education Institutions, Article 8 paragraph 1, point 1.4 of the regulation no. 02/2011 for fields of the administrative responsibility of the Prime Minister's Office and Ministries (official gazette no. 1, 18 April 2011), issues this:

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION
NO. ____/2018 ON THE CHIL-
DREN/STUDENT ONLINE PROTEC-
TION AT THE PRE-UNIVERSITY
EDUCATION INSTITUTIONS**

**Article 1
The purpose**

This administrative instruction has for purpose that upbringing-education institutions at the pre-university level, to address the protection of children / students online through the rule of law process and extra-

Ministar Obrazovanja, Nauke i Tehnologije,

na osnovu članu 4 stav 1, članu 5 stav 16 Zakona br. 04 / L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa Uredbom Vlade br. 21/2013 o Protokolu o prevenciji i prijavljivanju nasilja u institucijama preduniverzitetskog obrazovanja, član 8 stav 1 tačka 1.4 Uredbi br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava (Službeni glasnik br. 1, 18. april 2011.) izdaje:

**ADMINISTRATIVNA UREDBA
BR. ____/2018 O ZAŠTITI
DECE/UČENIKA NA INTERNET, U
INSTITUCIJAMA
PREDUNIVERZITETSKOG
OBRAZOVANJA**

**Član 1
Cilj**

Ova Administrativna uredba ima za cilj da edukativno-obrazovne i osposobljavajuće institucije na pred univerzitetskom nivou kako bi se usmerile na zaštiti deca / učenika na internet putem uređenog obrazovnog

arsimor dhe aktiviteteve jashtëmësimore, duke i përgatitur ata për përdorimin e sigurt të internetit, brenda mundësive dhe zhvillimeve teknologjike, në përputhje me zhvillimin e tyre të plotë në aspektin fizik, të komunikimit, social, emocional dhe intelektual.

Neni 2
Përkufizimet/ definicionet

1. Mbrojtja e fëmijëve në internet - është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit nëpërmjet internetit.
2. Masat e sigurisë- shfrytëzim i procedurave të caktuara, mjeteve ose programeve të specializuara kompjuterike me anë të të cilave qasja në sistemin kompjuterik është e kufizuar ose e ndaluar për kategoritë e caktuara të shfrytëzuesve.
3. Siguria në internet është njohja e maksimale e rreziqeve personale të sigurisë së përdoruesit ndaj informacionit dhe pronës private që lidhen me përdorimin e internetit dhe vetëmbrojtjen nga krimi kompjuterik në përgjithësi.
4. Zhvillimi fizik - ka të bëjë me shkathtësitë dhe mundësitë e trupit dhe

curricular activities, preparing them for the safe use of the Internet, within the possibilities and technological developments, in accordance with their full development in the physical, communication, social, emotional and intellectual aspect.

Article 2
Definitions

1. Children's Online Protection- is prevention and response to violence, abuse and use through the internet.
2. Safety measures – use of certain procedures, means or specialized computer programs, through which access to the computer system is limited or prohibited for certain categories of users.
3. Online safety is the maximum knowledge of personal safety risks and users safety to information and private property that are related to the internet use and self-defence from computer crime in general.
4. Physical development – this deals with skills and capabilities of the body and in-

procesa i vannastavnih aktivnosti, pripremajući ih za bezbednu upotrebu interneta, u okviru mogućnosti i tehnološkog razvoja, u skladu sa njihovim punim razvojem u fizičkom, komunikacijskom, društvenom, emocionalnom i intelektualnom aspektu..

Član 2
Definicije

1. Zaštita dece na internet - je prevencija i odgovor na nasilje, zlostavljanje i eksploataciju preko internet.
2. Mere bezbednosti - Korišćenje određenih procedura, sredstava ili specijalizovanih kompjuterskih programa kojima je pristup kompjuterskom sistemu ograničen ili zabranjen za određene kategorije korisnika.
3. Bezbednost na Internet je upoznavanje sa maksimalnim ličnim rizicima za bezbednost i bezbednost prema informacijama i privatnoj imovini vezano za upotrebu Interneta i samoodbranu od kompjuterskog kriminala uopšte.
4. Fizički razvoj - ovo se odnosi na veštine i telesne sposobnosti i uključuje: razvoj

<p>përfshin: zhvillimin e motorikës së përgjithshme, siç janë këmbët dhe duart; zhvillimi i motorikës së lehtë, siç janë pëllëmbët dhe gishtat. Këto duhet të merren parasysh kur vendosen rregulla për kohën e qëndrimit ulur para kompjuterit.</p>	<p>cludes: general motoric development such as legs and hands; light motoric development; such as palms and fingers. These should be taken into account when setting rules for the time sitting in front of computer.</p>	<p>opšte motorike, kao što su noge i ruke; razvoj lahke motorike, kao što su dlanovi i prsti. Treba se uzeti u obzir prilikom uspostavljanje pravila za vreme boravka pored kompjuter.</p>
<p>5. Zhvillimi social dhe emocional – është zhvillim i identitetit dhe ndjenjave për vetveten dhe mësimi i shkathtësive për të jetuar në shoqëri me njerëz të tjerë.</p>	<p>5. Social and emotional development – is development of identity and feelings for themselves and learning skills to live in society with other people.</p>	<p>5. Socijalni i emocionalni razvoj - je razvoj identiteta i osećaja za samog sebe i učenje veština za život u društvu sa drugim ljudima.</p>
<p>6. Zhvillimi intelektual – është mësim i shkathtësive të të kuptuarit, mbamendjes dhe përqendrimit.</p>	<p>6. Intellectual development – is learning understanding, memorizing and concentration skills.</p>	<p>6. Intelektualni razvoj - je učenje veština razumevanja, pamćenje i koncentracije.</p>
<p>7. Zhvillimi i komunikimit dhe të folurit – është mësim se si të komunikohet me miqtë, familjen dhe të gjithë të tjerët. Në këtë rast për qëllimet e këtij udhëzimi, bëjmë fjalë për komunikimin në internet.</p>	<p>7. Communication and speaking development – is learning on how to communicate better with friends, family and all others. In this case for purposes of this instruction, we refer to communication on the internet.</p>	<p>7. Razvijanje komunikacije i govora - je učenje kako komunicirati sa prijateljima, porodicom i svim ostalim. U ovom slučaju, u svrhu ove instrukcije, pozivamo se na komunikaciju na Internetu.</p>
<p>8. Shërbim arsimor - çdo veprimtari që është drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë e lidhur me mësimdhënien, si dhe çdo mbështetje materiale apo ndonjë formë tjetër.</p>	<p>8. Education service - any activity that is directly or indirectly related to teaching, as well as any material support or any other form.</p>	<p>8. Obrazovna služba - svaka aktivnost koja je direktno ili indirektno vezana za nastavu, kao i svaka materijalna podrška ili bilo koji drugi oblik.</p>
<p>9. Krimi kibernetik - një aktivitet kriminal të zhvilluar në rrjet që ka si objekt apo si mënyrë të kryerjes së krimit, keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave</p>	<p>9. Cyber Crime - a criminal activity developed in the network that has as object or as a way of committing the crime the misuse of computer systems and computer data.</p>	<p>9. Kriminalna kibernetika - kriminalna aktivnost koja se razvija u mreži koja ima cilj ili kao način izvršenja zloupotreba računarski sistema i kompjuterskih</p>

<p>kompjuterike.</p> <p>10. Të dhënat personale- çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.</p> <p>11. Abuzim - do të thotë çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm apo me paramendim nga prindi, kujdestari, ofruesi i kujdesit apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit ose autoritetit që shkakton ose ka gjasa të shkaktojë dëm fizik, psikologjik ose emocional ndaj fëmijës.</p> <p>12. Dhunë digjitale- nënkupton çfarëdo forme të dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonisë mobile. Ka për qëllim lëndimin, shqetësimin apo çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit të fëmijës, i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Shfaqet në formë të videos apo mesazheve tekstuale, fotografive apo thirrjeve;</p> <p>13. Materiale të papërshtatshme- nënkuptojnë materialet me përmbajtje të papërshtatshme për moshën e fëmijëve, të cilat cenojnë zhvillimin e fëmijëve në aspektin psikologjik, emocional, fizik dhe intelektual.</p>	<p>10. Personal data - any information relating to an identified or identifiable physical person.</p> <p>11. Abuse - means any intentional or premeditated act or omission by a parent, guardian, care provider or any other person in the position of trustee or authority, which causes or is likely to cause physical, psychological or emotional harm to the child.</p> <p>12. Digital Violence - means any form of sending messages via the Internet or mobile telephony. It is intended for injury, distress or any other kind of a child harm who cannot be protected by such actions. Appears in video or text messaging, photos or calls.</p> <p>13. Inappropriate materials - means improper material content that are inappropriate for children's age, which affect the development of children in psychological, emotional, physical and intellectual terms.</p>	<p>podataka.</p> <p>10. Lični podaci - svaka informacija koja se odnosi na identifikovano ili identifikaciono fizičko lice.</p> <p>11. Zloupotreba - podrazumeva svako namerno ili namjerno delovanje ili uz predumišljajem od strane roditelja, staratelja, pružaoca zbrinjavanja ili bilo koje drugo lice na položaju poverenika ili organa koji uzrokuje ili postoji mogućnost da izazove fizičku, psihičku ili emotivnu štetu detetu;</p> <p>12. Digitalno nasilje - znači svaki oblik slanja poruka putem Interneta ili mobilne telefonije. Koje imaju za cilj izazivanje uvreda, nevolje ili bilo kakvu drugu vrstu štete detetu koje se ne može zaštititi od takvih radnji. Prikazano u obliku video ili tekstualnih poruka, fotografija ili poziva;</p> <p>13. Neadekvatni materiali - podrazumeva materijali neprikladnog sadržaja za uzrast dece, koja se krše razvoj dece u psihološkom, emocionalnom, fizičkom i intelektualnom smislu.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 3 Mbrojtja e fëmijëve/nxënësve në internet</p> <p>Të gjitha institucionet edukativo-arsimore me veprimtarinë e tyre duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë përdorimit të internetit, duke garantuar përdorim të internetit në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Protection of children/students online</p> <p>All upbringing-education institutions with their activity should provide protection and security during internet use, guaranteeing internet use in useful and responsible manner.</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Zaštita dece/učenika na internet</p> <p>Sve edukativno - obrazovne institucije sa svojom delatnošću treba da obezbede zaštitu i bezbednost za vreme korišćenje interneta, garantujući korišćenje intereta na koristan i odgovoran način.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4 Roli i MASHT</p> <ol style="list-style-type: none"> MASHT, harton politika për mbrojtjen e fëmijëve në internet. MASHT, bashkëpunon dhe mbështetë iniciativat në nivel ndërkombëtar, rajonal, në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e politikave në mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve në internet. MASHT, planifikon aktivitete aftësuese dhe trajnuese për ngritjen e kapaciteteve në nivel shkolle e më gjerë: subjekte arsimore, prindër, shoqëri civile. MASHT, i mbështetë dhe monitoron institucionet edukativo-arsimore për zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve në internet. 	<p style="text-align: center;">Article 4 MEST's role</p> <ol style="list-style-type: none"> MEST compiles policies for protection of children online. MEST cooperates and supports international, regional, central and local initiatives for the implementation of policies on the protection of children / students online. MEST plans training and capability activities for capacity building at the school level and beyond: educational subjects, parents, civil society. MEST support and monitors upbringing – education institutions for policy implementation for protection of children online. 	<p style="text-align: center;">Član 4 Uloga MONT-a</p> <ol style="list-style-type: none"> MONT izrađuje politiku zaštite dece na internet. MONT saraduje i podržava inicijative na međunarodnom, regionalnom, centralnom i lokalnom nivou za sprovođenje politika zaštita dece / učenika na internetu. MONT planira aktivnosti osposobljavanja i obučavanja za izgradnju kapaciteta na nivou škole i šire: obrazovni subjekti, roditelji, civilno društvo. MONT podržava i monitorira edukativno - obrazovne institucije za sprovođenje politika za zaštitu dece na internetu

<p>5. MASHT, fuqizon mekanizmat për monitorim dhe raportim të abuzimeve në internet.</p>	<p>5. MEST empowers mechanisms for monitoring and report of online abuses.</p>	<p>5. MONT osnažuje mehanizme za monitoring i prijavljivanje zlostavljanja na Internetu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Roli i DKA-së</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 MED's role</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Uloga ODO-a</p>
<p>1. DKA, mbikëqyr dhe siguron që shkollat i zbatojnë politikat për mbrojtje të fëmijëve në internet.</p>	<p>1. MED supervises and ensures that schools to implement policies for protection of children online.</p>	<p>1. ODO nadgleda i obezbeđuje da škole sprovedu politiku za zaštitu dece na Internetu.</p>
<p>2. DKA, inicion dhe realizon aktivitete vetëdijesuese për mbrojtjen e fëmijëve në internet.</p>	<p>2. MED initiates and implements awareness activities for protection of children online.</p>	<p>2. ODO pokreće i sprovedi kampanje za podizanje svesti o zaštiti dece na Internet.</p>
<p>3. DKA, bashkëpunon dhe koordinohet me institucionet qendrore dhe lokale, qeveritare dhe joqeveritare për të parandaluar rreziqet në internet.</p>	<p>3. MED cooperates and is coordinated with central and local institutions, government and non-government institutions to prevent online risks.</p>	<p>3. ODO saraduje i koordinira sa centralnim i lokalnim institucijama, vladinim i nevladinim organizacijama radi sprečavanja rizika na internet.</p>
<p>4. DKA, planifikon buxhet për IT dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të internetit në institucione edukativo-arsimore.</p>	<p>4. MED plans budget for IT and service internet maintenance in the upbringing-education institutions.</p>	<p>4. ODO planira budžet za IT i održava internetske usluge u edukativno - obrazovnim institucijama.</p>
<p>5. DKA, mbështet iniciativat dhe koordinohet me partnerët dhe grupet tjera të interesit në nivel qendror dhe lokal për ta adresuar mbrojtjen e fëmijëve në internet.</p>	<p>5. MED supports initiatives and is coordinated with partners and other groups of interest at the central and local level, to address protection of children online.</p>	<p>5. ODO podržava inicijativu i u koordinaciji je sa partnerima i ostalim grupama od interesa na centralnom i lokalnom nivou kako bi se bavile zaštitom dece na internetu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 6</p> <p style="text-align: center;">Roli i institucioneve edukativo-arsimore</p>	<p style="text-align: center;">Article 6</p> <p style="text-align: center;">Role of the upbringing-education institutions</p>	<p style="text-align: center;">Član 6</p> <p style="text-align: center;">Uloga edukativno –obrazovnih institucija</p>
<p>1. Organet shkollore dhe koordinatori i cilësisë të sigurojnë që mbrojtjen e fëmijëve në internet ta bëjnë pjesë të planifikimeve si në:</p> <p>1.1. Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor;</p> <p>1.2. Aktivitete kurrikulare dhe ndërkurrikulare: planifikime vjetore, semestrare;</p> <p>1.3. Jashtëkurrikulare: projekte të ndryshme, ligjërata, debate, etj.</p> <p>2. Të gjithë ata që marrin dhe ofrojnë shërbime arsimore të raportojnë rastet e abuzimeve në internet dhe dhunës digjitale.</p> <p>3. Institucionet edukativo-arsimore të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar të bashkëpunojnë me të gjitha grupet e interesit, komunitetit e më gjerë për parandalim dhe reagim ndaj rreziqeve në internet.</p> <p>4. Staf i profesional: psikologu, pedagogu, mjeku, punëtori social, të mbështesin stafin</p>	<p>1. School bodies and quality coordinator ensure that child protection on the internet is part of the planning like in:</p> <p>1.1. Development plan of the upbringing-education institutions;</p> <p>1.2. Curricular and inter-curricular activities: annual, semi-annual planning.</p> <p>1.3. Extracurricular: various projects, lectures, debates etc.</p> <p>2. All who receive and offer educational services report cases of online abuses and digital violence.</p> <p>3. Upbringing-educational institutions of all levels of pre-university education cooperate with all interest groups, the community and beyond to prevent and respond to online threats.</p> <p>4. Professional staff: psychologist, pedagogue, doctor, social worker, support the</p>	<p>1. Školski organi i koordinatori za kvalitet osiguravaju da zaštita dece na Internetu bude deo planiranja kao:</p> <p>1.1. Plan razvoja edukativno - obrazovne institucije</p> <p>1.2. Kurikularne i među-kurikularne aktivnosti: godišnje, semestralno planiranje.</p> <p>1.3. Van-kurikularno: razni projekti, predavanja, debate, itd.</p> <p>2. Svi koji primaju i pružaju obrazovne usluge da prijave slučajeve zloupotreba na internet i digitalno nasilje.</p> <p>3. Edukativno - obrazovne institucije svih nivoa preduniverzitetskog obrazovanja da sarađuju sa svim interesnim grupama, širom zajednicom u sprečavanju i reagovanju na rizik od interne.</p> <p>4. Stručno osoblje: psiholog, pedagog, doktor, socijalni radnik, podržavaju</p>

<p>arsimor dhe nxënësit në parandalim, identifikim, trajtim dhe referim të rasteve të abuzimit në internet.</p>	<p>educational staff and students in prevention, identification, training and referral of online abuse cases.</p>	<p>obrazovni kadar i učenike u sprečavanju, identifikaciji, obuci i otkrivanju slučajeva zloupotrebe na internet.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Roli i mësimdhënësve</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Teachers role</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Uloga nastavnika</p>
<p>1. Mësimdhënësit të jenë pjesë e planifikimeve dhe realizimeve të:</p> <p>1.1. Planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor;</p> <p>1.2. Aktivitete kurrikulare dhe ndërkurrikulare (planifikime vjetore, semestrare);</p> <p>1.3. Jashtëkurrikulare (projekte të ndryshme, ligjërata, debate, etj).</p> <p>2. Mësimdhënësit të bashkëpunojnë me prindër, stafin arsimor dhe profesional dhe të tjerë për identifikimin e fëmijëve potencialisht viktimë të keqpërdorimeve dhe dhunës në internet.</p> <p>3. Mësimdhënësit të raportojnë rastet e abuzimeve në internet, sipas legjislacionit në fuqi, protokollit për parandalim të dhunës/modulit të incidentit në SMIA.</p>	<p>1. Teachers to be part of planning and realization of the:</p> <p>1.1. Development plan of the upbringing-education institution.</p> <p>1.2. Curricular and inter-curricular activities (annual, semi-annual planning),</p> <p>1.3. Extracurricular (various project, lectures, debates etc).</p> <p>2. Teachers cooperate with parents, educational and professional staff and others on identification of children who are potentially victims of misuse and violence online.</p> <p>3. Teachers report cases of online abuses, according to legislation in force, protocol on violence prevention / SMIA incident module.</p>	<p>1. Nastavnik da bude deo planiranja i realizacije.</p> <p>1.1. Razvojni plan edukativno - obrazovne institucije</p> <p>1.2. Kurikularne i među-kurikularne aktivnosti (godišnje, semestralno planiranje)</p> <p>1.3. Van-kurikularne (razni projekti, predavanja, debate, itd.).</p> <p>2. Nastavnici saraduju sa roditeljima, obrazovnim i stručnim osobljem i drugima kako bi identifikovali decu potencijalne žrtve zloupotrebe i nasilja na internet.</p> <p>3. Nastavnici prijavljuju slučajeve zloupotreba na internet, u skladu sa važećim zakonima, Protokolom o prevenciji nasilja / Modul incidenta u SMIO.</p>

<p>4. Mësimdhënësit të bashkëpunojnë me të gjitha grupet e interesit brenda shkollës (menaxhmentit të shkollës, organet e shkollës, këshillave të klasave, aktiveve profesionale, organet vendimmarrëse dhe profesionale), komunitetit e më gjerë për parandalimin e keqpërdorimit dhe dhunës në internet.</p> <p>5. Mësimdhënësit të mbrojnë të dhënat personale të fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>6. Mësimdhënësit duhet të përdorin materiale didaktike relevante dhe materiale /udhëzues të tjerë të punuara dhe sugjeruara nga MASHT, me qëllim të edukimit të fëmijëve për përdorim të internetit në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme.</p>	<p>4. Teachers cooperate with all groups of interest within the school (school management, school bodies, class councils, professional activities, decision-making and professional bodies and beyond for prevention of misuse and violence online.</p> <p>5. Teachers protect personal data of children according to the legislation in force.</p> <p>6. Teachers should use relevant didactic materials and other materials / guidelines worked and suggested by MEST, in order to educate children on internet use in useful and responsible manner.</p>	<p>4. Nastavnici saraduju sa svim učesnicima interesnih grupa unutar škole (menadžment škole, školske organe, razredni savet, profesionalne aktive, organi koji donose odluke i profesionalni organi), zajednice i šire u sprečavanju zloupotrebe i nasilje na internet.</p> <p>5. Nastavnici štite lične podatke dece prema važećim zakonima.</p> <p>6. Nastavnici treba da koriste relevantne didaktičke materijale i druge materijale / vodiče izrađenih i sastavljeni od strane MONT-a, u cilju vaspitanje dece za upotrebu Interneta na koristan i odgovoran način.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Roli i udhëheqësit të institucionit edukativo-arsimor</p> <p>1. Udhëheqësi i institucionit edukativo-arsimor ka këto detyrime:</p> <p>1.1. Zbaton politikat për përdorimin e internetit në mënyrë të dobishme dhe të përgjegjshme;</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Role of the upbringing-education institution leader</p> <p>1. The leader of the upbringing-education institution has these obligations:</p> <p>1.1. Implements policies on internet use in useful and responsible manner.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Uloga rukovodioca edukativno – obrazovne institucije</p> <p>1. Rukovodilac edukativno – obrazovne institucije ima sledeće obaveze:</p> <p>1.1. Sprovodi politike za korišćenje Interneta na koristan i odgovoran način.</p>


<p>1.2. Bashkëpunon me mësimdhënësit dhe stafin profesional për identifikim të nevojave dhe marrjen e masave parandaluese nga dhuna në internet;</p>	<p>1.2. Cooperates with teachers and professional staff on identification of needs and taking preventive measures for violence online.</p>	<p>1.2. Saraduje sa nastavnicima i stručnim osobljem kako bi identifikovali potrebe i preduzeli preventine mere protiv nasilja na internetu.</p>
<p>1.3. Planifikon, koordinon dhe monitoron aktivitetet e organeve të shkollës në parandalim dhe reagim ndaj keqpërdorimeve në internet;</p>	<p>1.3. Plans, coordinates and monitors activities of school bodies in prevention and response toward misuses online.</p>	<p>1.3. Planira, koordinira i monitorira aktivnosti školskih organa u sprečavanju i reagovanju na zloupotrebu interneta.</p>
<p>1.4. Bashkëpunon me organet dhe stafin e institucionit edukativo-arsimor, menaxhon dhe vendos rregulla për mënyrën e përdorimit të TI personale të nxënësve dhe mësimdhënësve në shkollë, duke siguruar përdorimin e dobishëm dhe të përgjegjshëm, bazuar në ligjet në fuqi;</p>	<p>1.4. Cooperates with bodies and upbringing-education institution staff, manages and establishes rules on how to use personal IT of students and teachers at school, ensuring useful and responsible use, based on laws in force.</p>	<p>1.4. Saraduje sa organima i osobljem edukativno - obrazovne institucije, menadžira i postavlja pravila u vezi upotrebe ličnu IT učenika i nastavnika u školi, osiguravajući korisno i odgovornu upotrebu, zasnovano na važećim zakonima.</p>
<p>1.5. Mbikëqyrë raportimin dhe referimin e rasteve të keqpërdorimit në internet;</p>	<p>1.5. Supervises reporting and referral of online misuse cases.</p>	<p>1.5. Nadgleda prijavljivanje i upućivanje slučajeva zloupotrebe na Internetu.</p>
<p>1.6. Udhëheqësi i shkollës identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të stafit arsimor dhe profesional në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve në internet;</p>	<p>1.6. The school leader identifies needs on capacity increase of the educational and professional staff regarding to children`s online protection.</p>	<p>1.6. Rukovodilac škole identifikuje potrebe za izgradnju kapaciteta obrazovnog i stručnog osoblja u vezi zaštitu dece na Internetu.</p>
<p>1.7. Koordinon stafin e shkollës për organizimin e trajnimeve me bazë në institucionin edukativo-arsimor, sipas</p>	<p>1.7. Coordinates the school staff to organize trainings based on the upbringing-education institution, according to</p>	<p>1.7. Koordinira školsko osoblje da organizuje obuke sa osnovom u edukativno - obrazovne institucije, u</p>

<p>kapaciteteve dhe mundësive poseduese;</p> <p>1.8. Në bashkëpunim me DKA, siguron shërbimin për mbikëqyrjen e internetit, zbatimin e platformave elektronike të miratuara nga MASHT dhe mbështetjen për stafin arsimor dhe nxënësit, për përdorimin e sigurt të internetit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Roli i Këshillit drejtues</p>	<p>the capacities and possession opportunities.</p> <p>1.8. In cooperation of MEDs provides service for internet surveillance, implementation of electronic platforms adopted by MEST and support for educational staff and students on the safe use of the internet.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Role of the Steering Council</p>	<p>skladu sa kapacitetima i mogućnostima posedovanja.</p> <p>1.8. U saradnji sa ODO pruža usluge nadgledanja interneta, implementaciji elektronskih platformi koje je odobrio MONT i podršku nastavnom osoblju i učenicima za bezbedno korišćenje interesa.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Uloga upravnog odbora</p>
<p>Këshilli drejtues shqyrton, sugjeron dhe aprovon programet dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve në internet brenda shkollës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Roli i Këshillit të prindërve</p> <p>1. Këshilli i prindërve bashkëpunon me mësimdhënësit, organet e shkollës dhe me grupet tjera të interesit në komunitet, si dhe sugjeron dhe inicion veprime për realizimin e programeve për mbrojtjen e fëmijëve në internet.</p> <p>2. Këshilli i prindërve reagon dhe paraqet shkeljet që lidhen me keqpërdorimet në internet, brenda dhe jashtë institucionit</p>	<p>Steering council reviews, suggests and approves programs and activities for the children's online protection within school.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Role of the Parent Council</p> <p>1. The Parent Council cooperates with teachers, school bodies and with other group of interest in the community, as well suggests and initiates actions for realization of programs for the children's online protection.</p> <p>2. The Parent Council reacts and presents violations related to internet misuse, inside and outside the institution according to pre-</p>	<p>Upravni odbor razmatra predlaže i odobrava programe i aktivnosti za zaštitu dece na internet u okviru škole.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Savetodavna odluka roditelja</p> <p>1. Savet roditelja saraduje sa nastavnicima, školskim organima i drugim zainteresovanim stranama u zajednici, te predlaže i pokreće aktivnosti za implementaciju programa zaštita dece na internetu.</p> <p>2. Savet roditelja reaguje i predstavlja kršenja koja nastaju zloupotrebom interneta, unutar i izvan institucije prema unapred</p>

<p>sipas procedurave të përcaktuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Roli i Këshillit të nxënësve</p>	<p>determined procedures.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Role of the Student Council</p>	<p>definiranim procedurama.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Uloga Saveta učenika</p>
<p>Këshilli i nxënësve angazhohet dhe koordinon nxënësit në realizimin e aktiviteteve vetëdijesuese për parandalimin dhe reagimin ndaj keqpërdorimeve dhe dhunës në internet.</p>	<p>Student Council engages and coordinates students in realization of awareness activities for prevention and response toward misuses and violence online.</p>	<p>Savet učenika se angazhuje i koordinira učenike u realizaciji aktivnosti podizanja svesti za prevenciju i reagovanje na zloupotrebu i nasilje na Internetu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Ngritja e kapaciteteve</p> <p>1. MASHT, DKA, institucionet edukativo-arsimore dhe grupet tjera të interesit, planifikojnë dhe koordinohen në ngritjen e kapaciteteve të stafit edukativo-arsimor dhe shërbimeve profesionale, për mbrojtjen e fëmijëve në internet.</p> <p>2. Ngritja e kapaciteteve rregullohet me U.A për ZHPM nr. 16/2013 për zhvillimin profesional të mësimeve dhe koordinohet nga KSHZHPM.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 The capacity increase</p> <p>1. MEST, MED, upbringing–education institutions and other groups of interest, plan and are coordinated in capacity increase of the upbringing–education staff and professional services on the children’s online protection.</p> <p>2. The capacity increase is regulated with AI for TPD no. 16/2013 on Teacher’s Professional Development from SCTPD.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Podizanje kapaciteta</p> <p>1. MONT, ODO, edukativno - obrazovne institucije i druge zainteresovane strane, planiraju i koordiniraju povećanje kapaciteta edukativno - obrazovnog osoblja i profesioanlnih usluga za zaštitu dece na internet.</p> <p>2. Izgradnja kapaciteta reguliše se AU za PRN br. 16/2013 za profesionalni razvoj nastavnika i u koordinaciji je sa DKPRN</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Sanksionimi</p> <p>Keqpërdorimet, abuzimet dhe shkeljet në përdorimin e internetit sanksionohen me ligjet vendore dhe ndërkombëtare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Sanctioning</p> <p>Misuses, abuses and violations on the internet use are sanctioned with local and international laws.</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Sankcioniranje</p> <p>Zloupotreba, zlostavljanje i kršenje upotreba Interneta sankcioniše se domaćim i međunarodnim zakonodavstvom.</p>

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit të tij nga Ministri.



Shyqiri Bytyqi ,

Ministër

Dt. 23 . 01 . 2019

Article 14
Entry into force

This administrative instruction enters into force seven (7) days after its signature by the Minister.

Shyqiri Bytyqi ,

Minister

Dt. _____ . _____ . _____

Član 14
Stupanje na snagu

Ova Administrativna uredba stupa na snagu sedam (7) dana nakon njenog potpisivanja od strane ministra.

Shyqiri Bytyqi ,

Ministar

Dt. _____ . _____ . _____